

**SA PLASTIKË
PËRDORET NGA
QYTETARËT E
PRIZRENIT?**

EC
MA NDRYSHË



Sa plastikë përdoret nga qytetarët e Prizrenit?

Autor dhe botues: EC Ma
Ndryshe

Rr. Fehmi Lladrovci 94, Prizren
& Bulevardi Nënë Tereza 30B
HI Nr.5, Prishtinë

www.ecmandryshe.org

info@ecmandryshe.org

029 222 771 & 038 224 967

Hulumtimi " Sa plastikë përdoret nga qytetarët e Prizrenit?" është realizuar nga EC Ma Ndryshe, i cili mbështetet nga Agjencia Suedeze për Zhvillim dhe Bashkëpunim Ndërkombëtar, (Sida) përmes Programit të saj "Human Rightivism" që implementohet nga Community Development Fund – CDF. Përmbajtja dhe qëndrimet e paraqitura këtu nuk përfaqësojnë qëndrimin zyrtarë të donatorëve.



Embassy of Sweden
Pristina



Prill, 2022

Në Direktivën e BE-së, mbeturinat konsiderohen si njëri ndër sektorët më kërkues në aspektin e resurseve njerëzore dhe financiare, që janë të nevojshme në përshtatjen e legjislacionit relevant të BE-së, dhe implementimin e masave të dizajnuara për të arritur rezultatet e kërkuara.

Ndotja nga plastika është shndërruar në një nga çështjet më urgjente mjedisore, meqenëse plastika përbëhet nga ndotës të mëdhenj toksikë dhe ka potencialin të shkaktojë dëme të konsiderueshme në mjedis (ndotje të ajrit, ujit dhe tokës).

Sipas shoqatës tregtare Plastics Europe, prodhimi i plastikës në mbarë botën u rrit nga rreth 1.5 milionë ton/në vit në vitin 1950 në rreth 359 milionë ton në vitin 2018. Rreth 12.7 milion ton hudhen në oqeanë çdo vit.

Meqenëse plastika sintetike është kryesisht e pabiodegradueshme, ato priren të vazhdojnë në mjedis natyror. Shumë produkte dhe materiale paketimi nga plastika përbëjnë afërsisht 50 % të të gjithë plastikës së prodhuar të cilat nuk depozitohen në kontejnerë për t'u larguar më pas në deponi, qendra riciklimi ose inceneratorë, e në vend të kësaj, ato asgjësohen në mënyrë të papërshtatshme.

Në korrik të vitit 2021 Bashkimi Evropian (BE) futi në fuqi Direktivën për Plastikën njëpërdorimshe. Ndër objektivat kryesore parashihet grumbullimi i 77% të shisheve plastike deri në vitin 2025 – duke u rritur në 90% deri në vitin 2029, si dhe të aplikohet 25% e plastikës së ricikluar në shisheet e pijeve PET nga viti 2025 dhe 30% në të gjitha shisheet plastike të pijeve nga viti 2030.

Në Kosovë ka mungesa të mëdha të klasifikimit të mbeturinave dhe të riciklimit të tyre, e gjithashtu hedhja e mbeturinave dhe e plastikës nëpër vende jo adekuate e nëpër rrugë është bërë një problem i madh për vendin tonë.

Sipas të dhënave të Doganës së Kosovës, për 3 vitet e fundit janë importuar afro 366 milionë kilogramë të produkteve të plastikës, të cilat kanë kushtuar rreth 662 milionë euro. Sipas këtyre të dhënave nga Dogana e Kosovës në tri vitet e fundit janë eksportuar mbi 63 milionë kilogramë produkte nga plastika.

Ndër prioritetet kryesore sa i përket menaxhimit të mbeturinave, në Strategjinë e Mbrojtjes së Mjedisit 2013-2022 është edhe vendosja e një takse mbi përdorimin e materialeve plastike (p.sh. shishe dhe qeset).

¹https://ec.europa.eu/environment/enlarg/pdf/pilot%20waste/Kosovo_al.pdf

²https://ec.europa.eu/environment/topics/plastics/single-use-plastics_en

³ www.kallxo.com

⁴ Strategjia e Mbrojtjes së Mjedisit 2013-2022

Sipas zëvendësministres së Ministrisë së Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës (MMPHI), Linda Çavdarbasha, për reduktimin e qeseve të plastikës njëpërdorimëshe kjo ministri ka formuar një grup punues ku janë të përfshira të gjitha palët e interesit dhe gjatë këtij viti do të përfundojë i gjithë procesi, në mënyrë që të fillohet me implementim nga viti 2023. Poashtu ajo theksoi që qeset e plastikës do të bëhen me pagesë (çmim ky i cili do të përcaktohet nga hulumtimi).

Përpos iniciativës për reduktimin e qeseve të plastikës, MMPHI në bashkëpunim me GLZ po punon poashtu edhe rreth projektit të Deposit Refund System (Sistemit të Kthimit të Depozitave) në të cilin do të përfshihet riciklimi i tri kategorive të mbeturinave: shishet e qelqit, shishet e plastikës dhe kanaçet.

Vendosja e një takse/pagese në shumë vende të botës ka rezultuar si zgjidhje e reduktimit të përdorimit të qeseve të plastikës.

Në vitin 2002, Republika e Irlandës u bë vendi i parë që vendosi një taksë për qeset plastike. Tarifa filloi nga 15 cent për qese dhe u rrit në 22 cent në vitin 2007. Qëllimi i taksës ishte që t'i inkurajojë blerësit të reduktojnë numrin e qeseve që përdorin. Kjo rezultoi në një rënie të menjëhershme të përdorimit të qeseve plastike nga rreth 328 në 21 qese për vit.

Poashtu në vitin 2014, një tarifë e detyrueshme për qeset plastike u vendos edhe në Skoci, duke vendosur

kështu një çmim minimal prej 0,05 GBP, tarifë kjo e cila ndikoi në reduktimin e përdorimit të qeseve plastike me rreth 80% duke arritur në të paktën 650 milionë qese më pak.

E në anën tjetër, ripërdorimi dhe riciklimi është prioritet i rëndësishëm strategjik, si në kuptim të zhvillimit të ekonomisë në Kosovë, ashtu edhe në kuptim të të qenit qenësor për arritjen e caqeve evropiane.

Hapi i parë do të jetë që të krijohen sisteme funksionale të ripërdorimit dhe riciklimit. Një rrjet i qendrave të riciklimit do të krijohet në tërë Kosovën. Këto qendra mund të jenë shumëfunksionale, duke përfshirë, për shembull, kompostimin e mbeturinave organike, zonat për ndarjen dhe magazinimin e mbeturinave të vëllimshme dhe impiantet për ndarjen dhe përgatitjen e mbeturinave të ambalazhit për ripërdorim dhe riciklim.

Në lidhje me përdorimin e plastikës, EC Ma Ndryshe ka realizuar një hulumtim me 141 respondentë nga qyteti i Prizrenit, nga lagjet: Ortakoll, Lakuriq, Bazhdërhanë, Jeta e re, Bajram Curr, Arbanë, Petrovë, Dardani, Lagjja e Trimave, Terzimahallë, Hoça Mahallë, Tabakhanë, Jeni Mahallë, Ralin dhe Kurillë. Përmes këtij hulumtimi synohet që të kuptohet sasia e plastikës që përdoret nga qytetarët e Prizrenit dhe njohuritë e tyre rreth ndikimit të plastikës në mjedis.

⁵ RTK-Radio Televizioni i Kosovës

⁶ www.impactdupage.org


⁷ www.oecd.org

⁸ Strategjia (2021-2030) dhe Plani i Veprimit (2021-2023) për Menaxhimin e Integruar të Mbeturinave në Kosovë

Çka përdorni zakonisht për t'i bartur produktet që bleni (markete, furra, barnatore, etj)?



Sa shpesh e përdorni plastikën njëpërdorimshe (gota, shishe, qese etj)



Nga produktet që bleni brenda një jave sa janë mesatarisht shishe plastike?




Në mënyrë mesatare sa qese plastike i merrni brenda një jave nga blerjet që bëni?



Si veproni me qeset e plastikës?



Cila është arsyeja kryesore që ju përdorni qese plastike?



Sa jeni në dijeni për ndikimin e dëmshëm të plastikës në mjedis?




Sa mendoni se janë të rinjtë në dijeni për ndikimin e dëmshëm të plastikës në mjedis?



Cila mendoni se do të ishte forma më efikase për informim?



Nëse qeset dhe shishet e plastikës do të ofroheshin vetëm me pagesë, si do të vepronit?



A e dini se shishet e plastikës e përmbajnë një numër që tregon nëse ai produkt është i riciklueshëm ose jo?



Cila mendoni se do të ishte mënyra më efektive për reduktim të përdorimit të plastikës?



PËRFUNDIME

- Nga 141 pjesëmarrës në kuadër të këtij hulumtimi, 127 prej tyre përdorin qese plastike të cilat ofrohen nga bizneset, 11 prej tyre përdorin çantat e tyre personale kurse 3 prej tyre përdorin qese letre.
- Nga të gjithë të anketuarit, 68 prej tyre kanë potencuar që pothuajse gjithmonë përdorin produkte plastike njëpërdorimshe, 40 prej tyre kanë potencuar që vetëm ndonjëherë i përdorin këto produkte, 26 prej tyre i përdorin pak kurse vetëm 7 prej tyre nuk përdorin aspak produkte plastike njëpërdorimshe.
- Shumica e të anketuarve brenda një jave blejnë 1-5 shishe plastike, saktësisht 50,4% e tyre, kurse në një përqindje më të vogël janë zgjedhur opsionet e tjera që nënkuptojnë blerjen e më shumë se 10 shisheve plastike. Kurse ngjashëm me shishe plastike, qëndron edhe përdorimi i qeseve plastike. 77 prej të anketuarve ose 54.6% e tyre janë shprehur se përdorin mesatarisht 5-10 qese plastike, 45 prej tyre përdorin 10-20 qese plastike brenda një jave, duke vazhduar me 14 respondentë të tjerë që janë shprehur se përdorin rreth 20-40 qese plastike brenda javës.
- Në kuadër të këtij hulumtimi qytetarët janë pyetur poashtu se si veprojnë me qeset plastike pas përdorimit të tyre. Pas përdorimit të këtyre qeseve, rreth 65% e qytetarëve janë shprehur se i ripërdorin kurse 35.5% i hudhin në mbeturina.
- E si arsye kryesore e përdorimit të qeseve plastike mbetet sepse fakti që ofrohen falas. 105 prej të anketuarve e kanë dhënë këtë arsyetim mbi përdorimin e qeseve plastike, ndërsa të tjerët janë shprehur që i përdorin duke qenë më praktike për përdorim të përditshëm.
- Gjatë këtij hulumtimi poashtu qytetarët janë pyetur se si do të vepronin ata nëse qeset dhe shishet e plastikës do të ofroheshin vetëm me pagesë në të ardhmen. 103 ose 73% prej tyre janë shprehur se nuk do të përdorin më fare plastikë, kurse 38 prej tyre ose 27% janë shprehur se do të paguanin sado që të jetë çmimi.
- E për ndikimet që shkakton plastika në mjedis shumica e të anketuarve janë në dijeni se çfarë dëme shkakton përdorimi i tyre, saktësisht 48.9% i janë përgjigjur opsionit "Shumë", 44.7% i janë përgjigjur opsionit "Deri diku", dhe 6.4% i janë përgjigjur opsionit "Aspak". Ndërsa si formë më efektive për informim rreth ndikimeve të plastikës, 59.6% e të anketuarve i kanë zgjedhur mediat (tv, radio, rrjete sociale), institucionet arsimore 27.7% kurse kampanjat vetëdijesuese në terren 11.3%.
- 59.6% e qytetarëve të anketuar nuk kanë qenë në dijeni se shishet e plastikës e përmbajnë një numër që tregojnë se sa bio-degradues është ai produkt, kurse

40.4% e tyre kanë qenë në dijeni për këto simbole që realisht janë simbole/numra (duke filluar nga 1 deri në 7) e që ofrojnë informacion të gjerë rreth kimikateve toksike që përdoren në produktet plastike.

- Poashtu në kuadër të hulumtimit ata janë pyetur edhe për mënyrën më efikase sipas tyre për reduktimin e përdorimit të plastikës. 42.6% ose 60 qytetarë janë shprehur se mënyra më e mirë është kushtëzimi me pagesë, 40.4% ose 57 prej tyre kanë zgjedhur opsionin “Heqja nga tregu”, ndërsa 14.9% ose 21 qytetarë mendojnë që informimi më i madh për dëmet që i shkakton plastika do të ishte opsion i reduktimit të përdorimit të plastikës.

REKOMANDIME

Promovimi i riciklimit të mbeturinave dhe shtytja institucionale përmes subvencionimit të kompanive të riciklimit do të nxiste ekonominë qarkore brenda komunitetit. Në anën tjetër stimulimi i qytetarëve për klasifikimin e mbeturinave në burim, të cilat mbeturina do të pranoheshin nga kompanitë e subvencionuara do të shtonin vlerë në ciklin e mbeturinave (sistemi i rimbursimit)

Promovimi dhe vetëdijësimi mbi ruajtjen e mjedisit përmes kampanjave që synojnë ndërgjegjësim të komunitetit rreth çështjeve mjedisore si dhe rreth reduktimit të produkteve plastike nga ana e qytetarëve dhe përdorimin e produkteve eko-miqësore në vend të tyre.

Të përcillen praktikat e fundit të BE-së në raport me trajtimin e produkteve të plastikës njëpërdorimshe dhe zëvendësimt të tyre në treg me produkte alternative.

EC angazhohet për qëndrueshmëri ekonomike dhe qeverisje demokratike në nivel lokal (dhe rajonal) përmes mobilizimit të komunitetit, mbikëqyrjes së vendimmarrjes publike dhe partneritetit në zbatim të programeve dhe politikave zhvillimore.

Për përmbushjen e këtij misioni organizata zbaton projekte dhe nisma në kuadër të dy programeve kryesore: Qytete/Komuna Gjithëpërfshirëse dhe Zhvillim i Qëndrueshëm. Ndërsa programi i tretë është ideuar si njësi mbështetëse për veprimin e organizatës dhe synon adresimin e tri sfidave të jashtme dhe të brendshme:

1. Vëllimin e pamjaftueshëm të dijës empirike në vend, përfshi të dhënat e besueshme statistikore, analizat e specializuara dhe mendimet profesionale,
2. Nevojën për konsolidimin e kapaciteteve të brendshme, veçanërisht në hulumtime, baza të të dhënave, analizë, menaxhim, zhvillim komunitar dhe ekspertizë sektoriale, dhe
3. Mungesën e qëndrueshmërisë financiare afatgjatë duke i diversifikuar burimet e të hyrave, me theks në ofrimin e shërbimeve për palët e treta.

Trekëndëshi konceptual që do të orientojë punën e organizatës në pesë vitet e ardhshme (2020 - 2024) ka këto elemente: 1. Gjithëpërfshirjen, 2. Qëndrueshmërinë, dhe 3. Dijen. EC beson se demokratizimi dhe zhvillimi i gjithëmbarshtëm shtetëror është proces që duhet planifikuar dhe ndërtuar nga poshtë lart.

Në thelb të qeverisjes demokratike qëndron hapja dhe përfshirja e të gjithëve në marrjen e vendimeve që kanë për synim të mirën e përbashkët, ndërsa planifikimi zhvillimor kërkon shfrytëzim racional të burimeve territoriale, pa e kompromituar përdorshmërinë e tyre nga gjeneratat e ardhshme. Si demokracia ashtu edhe zhvillimi duhen ndërtuar mbi bazën e dijës së shëndoshë që garanton vendime dhe veprime të mençura dhe vizionare.

Vlerat kryesore të organizatës janë:

1. Paanshmëria - EC vepron në bazë të analizave të thukta dhe gjithëpërfshirëse dhe mënjanon veprimet e ngutshme dhe impulsive. EC synon të përkrahë dhe të shtyjë përpara alternativat të cilat në bazë të hulumtimit dalin të jenë më të përshtatshmet, pavarësisht nëse masa e shoqërisë nuk e përkrahin këtë opsion;
2. Aktivizmi - Anëtarët e EC do të jenë aktivistë të cilët angazhohen në baza të rregullta për të shtyrë përpara bashkëveprimin qytetar për të përmbushur misionin e organizatës;
3. Orientimi drejt rezultateve - Anëtarët e EC janë të orientuar për të arritur rezultate, ku përpjekja nuk i kënaq pritjet e organizatës në qoftë se nuk përfundon me rezultatet e pritura;
4. Komuniteti bazë e veprimit - EC do të jetë gjithnjë pranë komunitetit, duke mësuar nga qytetarët dhe duke ndërtuar konsensus për bashkëveprimin dhe formësimin e shoqërisë.